TRIBUNA SINDIKALE

Prill 2009

Dhe drit' e diturisë
përpara do na shpjerë





Editorial

SYNIMI YNE : TE KONSOLIDOJME NJE ORGANIZATE SINDIKALE TE KOHES

Sindikatat qe jane krijuar dhe veprojne ne sektorin e arsimit, FSASH dhe SPASH, qe nga permbysja e sistemit monist diktatorial e deri me sot, ne perpjekjet per te mbrojtur gjithnje e me mire kerkesat dhe interesat sociale-ekonomike te anetareve qe perfaqesojne, kane arritur te formojne nje strukture dhe fizionomi te qendrueshme sindikale. Ato, kane rritur nga viti ne vit aftesite per te zhvilluar dialog real dhe efektiv me punedhenesin pothuaj ne te gjitha nivelet, gje qe gjen shprehje ne Kontratat Kolektive te Punes, kane persosur dhe fuqizuar aksionin sindikal duke e orientuar drejt dhe ne kohe levizjen sindikale ne arsim, kane vene bazat e nje kombinimi dhe harmonizimi te kerkesave sociale ekonomike te anetareve dhe angazhimin e perfshirjen e tyre ne procesin e reformimit dhe modrnizimit te shkolles.

Ne sherbim te kesaj strategjie sindikale ne sektorin e arsimit jane ndertuar e zbatuar disa fushata dhe projekte te lidhura mire midis tyre, te cilat kane synuar fuqizimin e kapaciteteve drejtuese te sindikatave qendrore dhe vendore, trajnimin dhe kualifikimin e lidershipit, shtimin e anetareve te rinj dhe programimin e zbatimin e nje pune te vecante me ta, zbatimin e disa projekteve konkrete per rritjen e rolit dhe te pergjegjersise se mesueseve gra ne sindikate, zhvillimin e aksioneve konkrete dhe te vazhdueshme per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve, duke kthyer ne shkolle dhjetra e dhjetra nxenes braktises dhe duke nxjerre nga rreziku i braktisjes qindra te tjere. Ne kete veprimtari dinamike e te vazhdueshme Sindikatat Qendrore te Arsimit jane mbeshtetur nga Federeta nderkombetare e Arsimit, EI, si anetare te saj; jane mbeshtur vecanrisht nga Sindikata Holandeze e Arsimit, AOb dhe Konfederata Holandeze e Sindikatave, FNV.

Keto qe permendem jane arritje serioze dhe nuk mund te mohohen. Por, kryesore eshte qe ne te mos ndalemi ketu, por sidomos ne analizat qe bejme e do te bejme gjate fushates se zgjedhjeve ne keshillat dhe seksionet sindikale, ne te gjitha strukturat deri ne Kongreset e SPASH dhe FSASH, te diskutojme dhe t'i japim pergjigje pyetjes se cfar duhet te bejme per te shkuar me tej per te ndertuar e konsoliduar gjate viteve qe vijne nje organizate sindikale moderne, te kohes. Kete e kerkon e ardhmja, e kerkojne interesat e mesuesve dhe gjithe punonjesve te arsimit, e kerkon nevoja per nje arsimim cilesor te brezit te ri, e kerkon interesi dhe perspektiva e vendit qe e mbeshtet zhvillimin dhe te ardhmen e tij, ne radhe te pare, mbi nje kapital njerezor te paisur me dije, shkence dhe kulture.

Natyrisht, nje objektiv i tille nuk arrihet per nje dite as per nje vit. Cdo proces progresi ka nje nisje. Dhe per ta nisur gjate kesaj fushate, lidershipi i te dy sindikatave, ne te gjitha nivelet, duhet te beje kujdes qe:

Se pari, te ndergjegjesohet lidershipi dhe anetaret lidhur me objektivin se nje sindikate moderne, e kohes, mbeshtetet mbi nje vizion, angazhim dhe kontribut me te gjere per mundesite dhe perspektivat e zhvillimit te sektorit ku ajo vepron. Sot dhe ne te ardhmen, jeta dhe veprimtaria sindikale nuk mund te kuptohen as te zhvillohen te mbyllura ne vetvete, jasht zhvillimit te shoqerise ne teresi dhe sektorit ku sindikata vepron vecanerisht. Kjo do te thote se sindikata nuk eshte nje shoqate e thjeshte, e painteresuar per zhvillimet politiko- shoqerore qe ndodhin rreth saj dhe ne te gjithe jeten e vendit. Perkundrazi, ajo duhet te jete nje organizate aktive qe u mundeson strukturave dhe anetareve te saj, te thone fjalen e tyre, te marrin pjese ne politikeberje, ne hartimin dhe permiresimin e legjislacionit dhe ne projektet e strategjite sektoriale. Vetem nga ky pozicion aktiv qe mundeson parashikimin e te ardhmes dhe parashikon pasojat e cdo procesi zhvillimi, sindikata i shikon me me largpamesi dhe i mbron me mire interesat jetike te anetareve qe perfaqeson duke filluar me garantimin e vendeve te punes, me permiresimin e sistemit te pagave e te shperblimeve, kohen e punes e te pushimit, etj.

Se dyti, kerkeses per vizion, angazhim dhe kontribut ne diskutimin dhe zgjidhjen e problemeve qe lidhen me progresin e nje sektori te vecante apo te shoqerise ne teresi, i pergjigjet vetem ajo sindikate qe ngrihet e funksionon mbi nje strukture organizative te ndertuar ne baze te legjislacionit kombetar dhe konventave nderkombetare te punes. Nje strukture mund te konsiderohet e konsoliduar kur inkurajon mundeson dhe garanton zhvillimin e demokracise ne sindikate, dhenien llogari dhe kontrollin mbi organet e zgjedhura, freskimin e lidershipit, rritjen e aftesise per dialog dhe aksion sindikal.

Se treti, Sindikatat duhet t'i kryejne ne menyre te pavarur detyrat e tyre themelore. Kjo arrihet kur ato jane te pavarura politikisht, organizativisht dhe financiarisht. Gjithe veprimtarine e saj sindikata e bazon mbi burimet e saj, mbi kuotizacionin e anetaresise, i cili duhet te administrohet me transparence te plote.

Evidentuam disa nga tiparet per nje sindikate te konsoliduar e moderne. Le t'i veme ato ne qender te diskutimeve, angalizave dhe programeve qe do te bejme gjate kesaj fushate te zgjedhjeve ne sindikatat e arsimit, si nje shprehje te vullnetit dhe vendosmerise sone per demokratizim, ndryshim dhe modernizim.

PERMBAJTJA

- *Editorial:* Synimi yne : Te konsolidojme nje organizate sindikale te kohes 2
- Me shume sherbime per mesuesit sindikaliste 3
- Tryeze mbi bashkepunimin midis Inspektoriatit Shteteror te Punes dhe Sindikatave per eliminimin e punes se femijeve 6
- Çdo mesues duhet te jete i sindikuar. Nga mbledhja e Këshillit Kombëtar të SPASH-it 8
- Vlerat sindikaliste Pervoje nga seksioni i FSASH, Pogradec 10
- Kongresi i 5te i SBASHK-ut te Republikes se Kosoves 12
- Strategjite dhe veprimet e sindikatave te arsimit per pagat ne kushtet e krizes globale 13
- Synimi i te gjitheve, asnje nxenes i larguar nga shkolla (Përvojë nga shkolla 9-vjeçare "Kamza e Re",Tiranë) 14
- Te reja shkencore dhe keshilla praktike 15

Kopertina e pare:
Moment nga punimet e Tryezes mbi sherbimet qe sindikatat u ofrojne anetareve
Kopertina e fundit:
Nga punimet e Kongresit te 5-te te SBASHK, Kosove

TRIBUNA SINDIKALE
Nr. 41
Prill 2009
Botim i FSASH dhe SPASH
Me mbeshtetjen financiare te Konfederates se Sindikatave te Holandes, FNV

ADRESA :
Rruga "Dora D'Istria", Pallati Perballe Fakultetit Juridik,Kati i 3-te, Tirane
Tel & Fax + 355 4 225 65 32
Celular: + 355 68 20 34 674,
+ 355 69 22 69 795, + 355 68 21 52 891
E-mail: fsash@abcom-al.com
Internet: www.fsash-spash.com

Keshilli Botues:
Xhafer Dobrushi,
Bajram Kruja,
Lumturi Mataj,
Defrim Spahiu,
Petref Çelaj,
Aleks Dushi,
Stavri Liko, Kryeredaktor

ME SHUME SHERBIME PER MESUESIT SINDIKALISTE

Nga Tryeza me pjesemarrjen e drejtuesve sindikaliste te qarqeve e rretheve

Ne vijim te aktiviteteve qe FSASH e SPASH jane duke organizuar ne zbatim te Projektit qe ato kane me sindikatat holandeze FNV/AOb, u organizua ne Tirane, Tryeza e mbi mundesine e zgjerimit te sherbimeve per anetaret, si domosdoshmeri per rritjen e numrit te tyre dhe fuqizimin e metejshem te sindikatave tona te arsimit.

Ne Tryeze moren pjese 24 pjesemarres, drejtues kryesore te seksioneve sindikale te FSASH e SPASH nga 16 rrethe, si edhe Zv. Presidenti i Sindikates se Arsimit te Holandes, AOb, Ton Rolvink dhe kryetaret e sindikatave tona te arsimit, Xhafer Dobrushi e Bajram Kruja,



Fjalen hyrese, ne emer te dy sindikatave tona te arsimit, e mbajti zoti Xhafer Dobrushi, i cili beri nje analize te arritjeve dhe situates aktuale ne lidhje me kete problem, duke evidentuar sherbimet kryesore qe sindikatat u ofrojne aktualisht anetareve, si edhe disa nga sherbimet kryesore qe ato synojne te sigurojne ne te ardhmen, vecanerisht nepermjet permiresimit te punes per zbatimin e kontrates kolektive ekzistuese, negocimeve per kontraten e re kolektive te punes, zgjerimit te bashkepunimit me institucione te tjera, sidomos banka, agjensi te sigurimeve shoqerore, agjensi turistike etj.

Ne vijim, zoti Ton Rolvink, pasi vleresoi punen e bere nga sindikatat shqiptare te arsimit gjate periudhes me shume se njevjecare qe nga Tryeza e meparshme, foli ne lidhje me pervojen e sindikates se arsimit te Holandes, AOb, duke evidentuar punen e madhe me shume se 10 vjecare qe eshte bere nga kjo sindikate per te reduktuar oret e punes per drejtuesit sindikalsite, si edhe metodat e punes te kesaj sindikate ne lidhje me mardheniet me qeverine dhe ministrine e arsimit, sidomos per ceshtjet qe kane te bejne me rritjen e pagave dhe mbrojtjen social ekonomike te anetareve.

Midis te tjerave, ai permendi ceshtjen thelbesore se kujt u sherbejne zgjidhjet qe bejne sindikatat; u sherbejne vetem anetareve te tyre, apo nga keto perfitojne te gjithe mesuesit? Ai theksoi se me ligj ne Holande, nuk mund te behet dallim midis anetareve te sidnkatave dhe mesuesve ne teresi ne lidhje me pagat, normat e punes etj. Por me marrveshje me Qeverine, ne Holande, anetaret e sindikates, ne raste te vecanta, perfitojne nga niveli me i ulte i takses mbi te

Vijon në faqen 4

Vijon nga faqja 3

ardhurat ne krahasim me mesuesit e tjere. Po keshtu, kur ka raste shkurtimesh, kur kriteret jane te njejta, mesuesit anetare te sindikates jane te fundit qe vihen ne listat e shkurtimeve nga puna. Ne te njejten kohe, ai theksoi se, si rezultat i punes qe AOb bene jo vetem me anetaret, por edhe me te gjithe mesuesit ne teresi, qeveria i akordon sindikates nje fond prej 15 Euro per cdo mesues, te ardhura keto qe perdoren per aktivitete sindikale.

Gjithashtu ai theksoi disa nga sherbimet e tjera qe AOb u ofron anetareve sidomos per asistence juridike, sherbime me te favoreshme me agjensite e sigurimeve shoqerore, me bankat, me agjensite turistike, organizimin e kurseve te kualifikimit profesional dhe aktiviteteve te tjera me interes per anetaret, botimet e ndryshme me karakter profesional dhe me informacione per tregun e punes dhe proceduart e punesimit, te cilat shperndahen falas vetem per anetaret e sindikates etj.

Ne nderhyrjet e bera nga Kryetari i SPASH-it, zoti Bajram Kruja, pasi vleresoi e falenderoi FNV dhe AOB per kontributin qe po japin per forcimin e sindikatave tona, vuri ne dukje edhe domosdoshmerine e forcimit te bashkepunimit me Ministrine e Arsimit dhe Shkences, zbatimin e Kontrates Kolektive te Punes, si edhe domosdoshmerine per nje angazhim me te mire te drejtuesve sindikaliste ne qarqe e rrethe per realizimin e marrveshjeve me interes per mesuesit anetare te sindikatave.

Duke e marre fjalen ne Tryeze, pjesemarresit, kryetare te seksioneve sindikale te qarqeve e rretheve vleresuan punen e bere deri tani nga te dyja sindikatat e arsimit, sidomos nepermjet Kontrates Kolektive te Punes, por nderkohe ata kerkuan me shume angazhim dhe plane konkrete per zgjerimin e sherbimeve vetem per anetaret, mbasi kjo eshte menyra me e mire per t'i terhequr te gjithe mesuesit ne radhet e sindikatave.

Disa prej tyre, si Shpetim Sino e Lavdosh Llanaj, (Fier), Aleks Dushi e Isa Reka, (Shkoder), Bukuroshe Shabani e Elizabeta Myftari (Elbasan), Istref Haxhillari, (Pogradec), Albina Pepo e Hektor Fejzulla, (Korce), etj, e vune theksin tek permiresimi i metejshem i pagave dhe motivimi me i mire i mesuesve per pune shtese, tek veprimet konkrete te organeve qendrore te sindikatave per sigurine e vendit te punes dhe shmangien e pushimeve e transferimeve te pamotivuara nga puna, ndihma juridike, problemet e kualifikimit profesional te mesuesve, hartimi dhe miratimi i Statusit te Mesuesit, si edhe tek zbatimi i pervojes holandeze dhe asaj te vendeve te tjera, sidomos ne drejtim te mardhenieve favorizuese me agjensite e sigurimeve shoqerore, me bankat, agjensite turistike etj.

Me shume interes ishte puna ne grupe e pjesemarresve ku diskutuan, nxuaren konkluzione dhe bene propozime konkrete, sidomos per problemet kryesore qe do te jene objekt i negocimeve me Ministrine per Kontraten e re kolektive te punes, si edhe per ceshtjet qe kane te bejne me mardheniet e punes, ndihmen juridike, mardheniet me subjekte te tjera etj, mbi bazen e te cilave u perpunua nje Plan Veprimi, i cili do te jete objekt i punes konkrete te te dyja sindikatave per nje afat kohor relativisht te gjate.

Drejtuesit e te dy Sindikatave Qendrore falenderuan kolegun nga sindikata e arsimit e Holandes, AOb, Zv/Presidentin e saj, Z. Ton Rolvink per kontributin qe FNV dhe AOb po japin dhe per gjithcka qe ato po bejne per te ndihmuar e fuqizuar sindikatat tona dhe per te modernzuar sistemin arsimor ne vendin tone.

Ne vijim po botojme nje permbledhje nga Fjala Hyrese qe u preantua ne kete Tryeze, ne te cilen u theksua se:

" Pak me shume se nje vit me pare, pikerisht me 23 shkurt 2008, ne organizuam per here te pare nje Tryeze te tille dhe beme perpjekje per te ndertuar nje program veprimi lidhur me sherbimet qe sindikatat do t'u ofronin anetareve. Kemi punuar gjithe keta muaj per ta zbatuar kete program dhe sot, ne kete Tryeze te dyte, kemi rastin dhe mundesine te bejme nje analize te punes dhe veprimtarise sone ne keto drejtime, te vleresojme anet e mira dhe te dobeta dhe te ecim me tej ne plotesimin e synimeve tona.

Konkluzioni kryesor qe mund te nxjerrim per problemin qe po analizojme dhe per periudhen qe po marrim ne shqyrtim eshte se stafet drejtuese te te dy sindikatave tona, pra lidershipi i tyre, si ne nivel qendror ashtu edhe ne nivel vendor, kane tani nje vizion me te qarte per *lidhjen qe ekziston midis kerkesave te pergjithshme qe shtrojne dhe dialogojne sindikatat per mbrojtjen e interesave sociale dhe ekonomike te mesuesve dhe gjithe te punesuarve te tjere ne arsim, qe perben funksionin themelor te nje sindikate, nga njera ne, dhe zgjidhjes se disa kerkesave specifike, perfshire sherbimet qe ofron vete sindikata vetem per anetaret e saj, qe eshte me teper nje problem i konsolidimit te brendshem te nje sindikate, nga ana tjeter.*

Le te bejme tani nje analize me konkrete te kesaj situate. Ne Tryezen e vitit qe shkoi ne percaktuam 6-7 objektiva qe synonim te arrinim. Me konkretisht:

1. Ne programuam qe te negocojme me MASH per te bere te mundur qe pagesen per nje vizite mjeksore ne vit, qe cdo mesues eshte i detyruar ta beje duke paguar 500

leke te reja, per anetaret e sindikates ta perballoje punedhenesi, dmth DAR/ZA. Bisedimet u zgjaten dhe nuk u arrit qe kjo marreveshje te nenshkruhej para fillimit te vitit te ri shkollor 2008/2009. Ne muajt e pare te ketij viti kemi arritur ne nje marreveshje ne parim per kete zgjidhje, e cila shpresojme se do te finalizohet me rastin e disa plotesimeve qe do t'i behen KK te Punes.

2. Per rastin e kurimit te semundjeve te renda, qe kerkojne kosto te larte, si brenda dhe jashte vendit, ne kemi filluar ta veme ne jete kete kerkese ne disa rrethe, ku edhe mesueseve gra qe jane operuar ose kuruar per semundje te renda, t'u mundesojme nje ndihme prej 20.000 deri ne 40.000 leke te reja. **Mbetet te kembengulim qe kjo praktike te behet unike dhe te perfshihet si norme ne Kontraten e re Kolektive te punes**.

3. Tani FSASH dhe SPASH jane ne gjendje te mbajne premtimin qe per mesuesit anetare te sindikates, te cilet kane femije qe ndjekin studimet e larta ne arsimin publik, me kusht qe te ardhurat e tyre si familje jane nen minimumin jetik, t'u perballojne cdo vit 20-50 perqind te kostos se shkolles se larte, per l femije. **Mbetet qe Seksionet Sindikale te FSASH/ SPASH ne qarqe e rrethe t'I bejne jehone ketij premtimi dhe te evidentojne rastet konkrete.**

4. Duke filluar nga ky vit shkollor e ne vazhdim kerkesat ndaj mesuesve per rritjen e aftesive profesionale do te vijne duke u shtuar. Ne tashme jemi te gatshem qe t'u pergjigjemi anetareve te sindikatave tona per t'u ofruar nje kurs trajnimi profesional ne vit falas.

5. Tani kemi bere realitet qe cdo sindikalist qe kerkon te kete revisten " Tribuna Sindikale", secila sindikate ua jep falas anetareve te saj.

6. FSASH dhe SPASH do te fillojne te ofrojne per anetaret e tyre konsulence ligjore falas, sipas kerkesave. Duke filluar nga muaji maj I ketij viti, ne do te hape nje zyre ne Tirane dhe nje ne Durres, ku nje here ne muaj specialiste te se drejtes se punes, te ligjit te pensioneve, etj., do te jene ne dispozicion te anetareve te sindikates per t'iu pergjigjur pyetjeve qe ata kane bere dhe depozituar ne seksionit sendikale gjate muajit. Per marredheniet e punes do te kete edhe mbrojtje ligjore falas.

Pervec ketyre objektivave qe percaktuam ne Tryezen e pare, FSASH/SPASH , mbeshtetur ne disa dispozita te KK te Punes te nivelit te pare, jane kujdesur qe te bejne ne favor te mesuesve dhe drejtuesve sindikale disa zgjidhje ne favor te tyre, perfitime qe nuk i gezojne te gjithe mesuesit e mbrojtur me Kontrate Kolektive dhe konkretisht:

1. Eshte bere hapi i pare per motivimin e mesuesve sin dikaliste dhe drejtuesve sindikal. Me propozimin e perbashket te te dy sindikatave qendrore jane shperblyer disa kryetare seksionesh ne fund te vitit deri ne masen e nje page mujore. Nje pjese e mire e kryetareve e kane perfituar kete shperblim. Ne disa rrethe jane propozuar per t'u motivuar edhe sindikaliste, kryesisht gra, qe jane dalluar ne veprimtarite per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve. **Mbetet qe kjo nisme te saktesohet e pergjithesohet ne shkalle vendi dhe te perfshihet ne aneksin e KK te Punes ekzistuese dhe ne Kontraten e re Kolektive, qe do te negocohet nga fundi i vitit.**

2. Do te vazhdojne perpjekjet dhe bisedimet per te rivendosur normen e shperblimit deri ne 2 paga per mesuesit sindikaliste qe dalin ne pension. Qe nga Tryeza e vitit te kaluar ne kete ceshtje eshte bere nje hap i ndjeshem. SPASH/FSASH arriten qe kete ceshtje ta bejne objekt diskutimi ne nje mbledhje te posacme te Keshillit Kombetar te Punes. KK i Punes e konsideroi te drejte kerkesen e sindikatave tona dhe unanimisht doli me nje vendim ne favor te tyre. Kjo eshte nje mbeshtetje per ta zgjidhur kete kerkese.

3. Nje mbrojtje me konkrete eshte bere per drejtuesit dhe mesuesit anetare te sindikates lidhur me marredheniet e punes, perfshire largimet nga puna dhe ndryshimin e vendit te punes.

Ka gjetur shume mbeshtetje tek sindikalistet qendrimi i vendosur i FSASH per rreth 3.000 mesues qe rrezikonin vendin e punes, duke arritur qe Qeveria te anullonte me vendim Urdherin perkates te Ministrit te Arsimit; jane korrigjuar shumica dermuese e vendimeve te padrejta per ndryshimin e vendit te punes te drejtuesve te disa seksioneve sindikale, jane anulluar largimet e padrejta nga puna qe kane bere disa DAR/ZA, etj.

4. Drejtuesve sindikaliste ne shkalle rrethi dhe mesuesve kujdestare u jane krijuar kushte te favorshme per pune, duke u reduktuar normen mesimore.

5. Veprimtareve sindikale ne rang rrethi dhe shkolle dhe cdo sindikalisti u eshte siguruar leje e pagueshme per trajnim dhe veprimtari te tjera sindikale kombetare e nderkombetare per aq kohe sa zgjat aktiviteti, etj.

Te gjithe keto zgjidhje, perfitime dhe sherbime qe u jane ofruar mesuesve sindikaliste dhe drejtuesve te tyre, gjate gjithe fazes se zbatimit te projektit me AOB/FNV, nuk kane kaluar pa u ndjere. Ndikimi i tyre eshte nder aresyet kryesore qe ka bere qe gjate kesaj periudhe ne SPASH, gjate vitit te pare te projektit jane anetaresuar 1300 mesues te rinj, ndersa ne FSASH kane ardhur 700 anetare te rinj.

Tryeze mbi bashkepunimin midis Inspektoriatit Shteteror te Punes dhe Sindikatave per eliminimin e punes se femijve

Ne vijim te problemeve qe u ngriten dhe te kerkesave qe u bene nga sindikatat ne Tryezen e organizuar nga FSASH e SPASH ne fund te muajit shkurt te ketij viti per nje bashkepunim me efektiv midis Inspektoriatit Shteteror te Punes dhe sindikatave, ne daten 27 mars u organizua ne ambientet e Ministrise se Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, nje Tryeze, me pjesemarrjen e perfaqesuesve nga Ministria e Punes e sidomos nga Inspektoriati Shteteror i Punes dhe Drejtoria e Mardhnieve te Punes, Ministria e Arsimit dhe Shkences, ILO-IPEC, sindikatat e arsimit, FSASH e SPASH, si edhe sindikatat e disa degeve te tjera ne perberje te BSPSH dhe KSSH, si ato te Tekstil Artizanatit, Ndertimit, Bujqesise, Industrise se Lehte, Shendetesise etj.

Ne tryeze moren pjese dhe kontribuan, gjithashtu, Zv/Ministri i Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, Z. Kastriot Sulko, Drejtori i Mardhenieve te Punes prane kesaj Ministrie, Z. Bujar Cani, Drejtori i Inspektoriatit Shteteror te Punes, Z. Thoma Melo, perfaqesuesi i Ministrise se Arsimit dhe Shkences, Z. Novruz Ahmeti, Menaxherja Kombetare e ILO-IPEC ne Shqiperi, Zj. Etleva Vertopi, Kryetari i Konfederetaes se Sindikatave te Shqiperise, Z. Kole Nikollaj, Kryetari i FSASH-it, Z. Xhafer Dobrushi, Kryetari i SPASH-it, Z. Bajram Kruja etj.

Tryeza u hap nga kryetari i FSASH-it, Z. Xhafer Dobrushi. Ne vijim, Zv/ Ministri i Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, Z. Kastriot Sulko, beri nje paraqitje te punes dhe objektivave te kesaj Ministrie per shmangien e informalitetit, evidentimin dhe shmangien e punes se femijeve, duke u fokusuar tek permiresimi i legjislacionit dhe monitorimi i vazhdueshem i fenomenit, sidomos ne sektoret ku informaliteti eshte me i pranishem.

Prezantimin kryesor mbi punen e bere, rezultatet e arritura dhe drejtimet kryesore per forcimin e bashkepunimit midis Inspektoriatit Shteteror te Punes dhe Sindikatave per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve, e mbajti perfaqesuesja e Inspektoriatit Shteteror te Punes, Zj. Evis Qaja, e cila e vuri theksin tek domosdoshmeria e evidentimit dhe informimit nga ana e sindikatave ne lidhje me informalitetin dhe beri disa propozime konkrete ne lidhje me perpjekjet e perbashketa dhe veprimet e ndersjellta, qe kane te bejne, sidomos me identifikimin e femijeve te moshes 14-18 vjec, qe punojne ne sektoret perkates, mbi zbatimin e legjislacionit ekzistues dhe permiresimin specifikat e tyre. Keshtu, ne kater shkollat pilot qe jane perfshire ne program nga rrethi i Fierit, sindikatat kane ne fokusin e punes se tyre kryesisht nxenesit nga komuniteti rom, ne shkollat e Elbasanit mesuesit sindikaliste punojne per te kthyer ne shkolle dhe nxjerre nga rreziku i braktisjes nxenesit nga komuniteti rom dhe egjiptian, ne zonen e Bathores (Qarku Tirane- Bashkia Kamez) mesuesit sindikaliste punojne kryesisht me vajzat nxenesve ne klasen e 7-te, te 8-te dhe te 9-te ku rreziku i braktisjes eshte me i madh, etj



e metejshem te tij, duke perfshire gjithnje e me teper edhe partnere te tjere ne keto perpjekje.

Ne vijim, ne emer te dy sindikatave te arsimit, Kryetari i FSASH-it, Z. Xhafer Dobrushi, foli mbi angazhimin e mesuesve e sindikalisteve, sidomos ne shtate rrethet e perzgjedhura, duke perfshire edhe disa sindikata te degeve te tjera, mbeshtetur edhe nga sindikatat holandeze, FNV/ dhe AOb.

Ai evidentoi pervojen e mire te sindikatave te arsimit per parandalimin e punes se femijeve. Ai tha se rrethet e selektuara ne te cilat sindikatat punojne me programe dhe objektiva konkrete, nuk jane zgjedhur rastesisht. Ne keto rrethe jane rreth 50 perqind e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen ne shkalle vendi. Por edhe keto rrethe kane

Diskutimet e perfaqesusesve te subjekteve te tjera pjesemarrese, (Etleva Vertopi, ILO-IPEC, Kole Nikollaj, KSSH, Thoma Melo, ISHP, Nevruz Ahmeti, MASH), u perqendruan ne angazhimin e organizmave respektive per parandalimin dhe eliminimin progresiv te punes se femijeve, si edhe per mundesite e zgjerimit te bashkepunimit midis gjithe aktoreve pjesemarres ne kete Tyeze, ne te ardhmen.

Duke marre ne konsiderate rendesine e ketij bashkepunimi edhe ne nivel lokal, nje nga konkluzionet e rendesishme te kesaj tryeze ishte angazhimi i Inspektoriatit Shteteror te Punes dhe sindikatave te arsimit, per te organizuar Tryeza te tilla diskutimesh edhe ne nivel qarqesh e rrethesh, me

pjesemarrjen e aktoreve respektive lokale.

Me shume se 10 kanale televizive paten reporteret e tyre ne kete aktivitet, te cilet theksuan rrezikshmerine e ketij fenomeni per shoqerine dhe dhane informacion ne lidhje me angazhimin e sindikatave dhe bashkepunimin e tyre me Inspektoriatin Shteteror te Punes dhe aktoret e tjere, per parandalimin dhe eliminimin progresiv te punes se femijeve, duke vleresuar edhe kontributin e sindikatave holaneze FNV e AOb ne arritjen e rezultateve pozitive.

Ne vijim botohet nje permbledhje e Prezantimit te Zj. Evis QAJA, ne emer te Inspektoriatit Shteteror te Punes.

Inspektoriati Shtetëror i Punës, si një institucion i domosdoshëm në politikat sociale të shtetit, parandalon dhe mbron shëndetin dhe sigurinë e fëmijëve, duke nxitur zbatueshmërinë e legjislacionit të punës, lidhur me sigurimin dhe mbrojtjen e integruar si fizike, mendore dhe sociale të tyre, nëpërmjet plotësimit të kërkesave të standardeve ndërkombëtare.

Ne si Inspektorat, duke ditur dhe kuptuar rëndësinë si i vetmi institucion ekzekutiv që ka te drejten te kontrolloje zbatimin e Legjislacionit te Punes dhe respektimin e dispozitave ligjore, i kemi dhënë përparësi dhe prioritet këtij grupi, pra fëmijëve. Në fakt fuqia punëtore e fëmijëve është një rreth vicioz që nuk i pasuron kombet, por shkakton vetëm varfëri. Arsyeja është se, nëse fëmijët punojnë, sigurisht jashtë standardeve të përcaktuara, vetkuptohet se niveli arsimor, cilësia e punës apo e profesionit dhe përqindja e fitimit do të ulet. Mungesa e ushqimit cilësor, strehimi i keq dhe mungesa e imunitetit nga sëmundjet sjellin aftësi të pakta për punë dhe varfëri. Të gjitha këto kushte të papërshtatshme pune kanë shumë ndikim tek fëmijët për gjithë pjesën tjetër të jetës. Pra, duke e parë në këtë aspekt problemin, ISSH luan një rol të rëndësishëm në zbatimin dhe kontrollin e këtyre dispozitave ligjore si dhe i ka kushtuar nje kujdes te vecante kontrollit te zbatimit te Legjislacionit te Punes ne drejtim te te punesuarve nen moshën 18 vjec.

Pervecse faktit qe femijet perfitojne nga te njejtat te drejta si edhe te rriturit, mungesa e tyre e njohjes, pervojes dhe fuqise, kerkon qe ata te gezojne edhe te drejta te tjera, nga te cilet eshte e drejta per mbrojtje ndaj shfrytezimit ekonomik dhe nga pune qe mund te pengojne zhvillimin e tyre.

Ka shumë arsye që, edhe pse në moshë të vogël, grupe fëmijësh janë shtyrë të punojnë në vende pune jo shumë të përshtatshme. Varfëria, migrimi nga vendet rurale në ato urbane, niveli arsimor i prindërve, etj. janë disa nga shkaqet kryesore që i shtyjnë këta fëmijë të punojnë. Veçanërisht ka raste kur familjet migruese nga fshatrat, pjesën më të madhe të kohës e kalojnë në lagje periferike, pa ndonjë ambient të shëndetshëm dhe me një punë që nuk paguhet mirë. Si pasojë, çdo pjesëtar i familjes është një fuqi punëtore më vete. Shpeshherë fëmijët janë punëtorët që përshtaten më mirë me këtë lloj situate, sepse prindërit nuk kanë të drejtë të zgjedhin një punë të kualifikuar, prandaj është e vështirë për këta prindër të fitojnë të ardhura të mira. Disa keqkuptime kulturore i shtyjnë gjithashtu fëmijët të gjejnë një punë. Për shembull, në disa kultura, shumë familje mendojnë se fëmijët e tyre duhet të parapërgatiten për të përballuar jetën në të ardhmen. Ky mendim i detyron shpeshherë fëmijët që të punojnë që në moshë të vogël, duke humbur mundesite per arsimim.

Në bazë të inspektimeve të kryera nga Inspektorati Shtetëror i Punës është konstatuar se fushat ku punojnë fëmijët janë përqëndruar në:

1) Ndërrmarje Prodhuese:

Konkretisht në prodhimin e këpucëve, veshjeve, etj. Për vitin 2007 në prodhimin e këpucëve puna e femijve ze 8,8% ndërsa ne vitin 2008 13 perqind.

2) Bujqësi, pyje, peshkim, ku numëri i fëmijëve të punësuar rezulton të jetë për vitin 2007 12% , ndërsa për vitin 2008: 23,9%.

3) Ne aktivitete të tjera, nga kontrollet e ushtruara rezulton se numëri i fëmijëve të punësuar për vitin 2008 të jetë 20. Disa fëmijë punojnë, gjithashtu, si kamarierë apo pjatalarës në kafene, restorante, etj

Nga sa u tha më sipër, del se parandalimi i praktikave te padrejta te punesimit, i demtimeve, problemeve shendetesore ose konflikteve, si edhe monitorimi i punes se femijve jane elemente te rendesishme te cilat duhen mbajtur parasysh. Sot, objektivi i synuar perfshiner zhvillimin e nje ***"kulture parandaluese"*** ne pune, dhe një mardhënie konseguente me biznesin, e cila do te synoje te veje te gjithe vendet e punes ne perputhje me standarde te pranuara gjeresisht nga komunitetet. Metoda parandaluese ne inspektimin e punes kerkon nga inspektori te jete se pari nje keshilltar dhe pastaj nje autoritet shtrengues, kur keshilla e tij nuk merret parasysh.

Kjo sfide qendron per te gjithe ne qe jemi te angazhuar ne fushen e inspektimit, per te testuar dhe krijuar masa te metejshme efikase per te arritur qellimin madhor të eleminimit te formave te keqia lidhur me punën e fëmijëve.

Në këtë aspekt, konsultat dhe sugjerimet e Inspektoratit kanë synuar qe punedhenesit te mos perdorin punen e fëmijëve, duke ndikuar drejtperdrejt ne rritjen e fenomenit te braktisjes se shkolles dhe shtimin e numrit te analfabetve ne shoqeri.

Në këtë këndvështrim, në bazë të inspektimeve të ushtruara nga Inspektorati, konstatojmë ne mjaft raste një ndërgjegjësim të vetë punëdhënësve në mardheniet e tyre kundrejt punësimit të fëmijëve. Kështu në analizën e bërë për fëmijët e evidentuar pa Autorizimin e Inspektoratit, e krahasuar me vitin 2007, rezulton te jene 114 njësi më pak

E njëjta situatë artikulohet dhe në sigurinë dhe shëndetin në punë bërë për fëmijët e evidentuar pa Ekzaminimin Mjekësor, ku, krahasuar me vitin 2007, del te jene 104 njësi më pak.

Së fundi, nenvizojme se qëllimi ynë në parandalimin e punës së fëmijëve lidhet me koordinimin sa më të mirë dhe për një bashkëpunim sa më efektiv me sindikatat, partnerët socialë ndërkombëtarë siç është ILO - IPEC, UNICEF etj.

ÇDO MËSUES DUHET TE JETË I SINDIKUAR

Nga mbledhja e Këshillit Kombëtar të SPASH-it

Në mbledhjen e datës 10.04.2009 të Këshillit Kombëtar të SPASH, ku moren pjesë drejtues të këshillave sindikale të SPA të 27 rretheve, u trajtuan dy probleme kryesore:

1-Mbi ndryshimet në statutin e SPASH

2-Ecuria e zgjedhjeve në shkolla.

Në fjalën e hapjes që mbajti Presidenti i SPASH, Z.Bajram Kruja, në emër të Komitetit Drejtues, ndër të tjera, vlerësoi fillimin e mbarë të fushates zgjedhore per zgjedhjen e dala gjate procesit zgjedhor në shkolla për secilin rreth.

Z. Haxhi Meçuli, kryetar i SPA të qytetit të Tiranës, nder te tjera, tha se këto zgjedhje po na shërbejnë edhe për të verifikuar më mirë anëtarësinë tonë aktuale, pasi ka patur shumë lëvizje të mësuesve nga një shkollë në tjetrën. Gjithashtu, po punojmë për të rritur numrin e anëtarësisë, ku dua të them se gjatë dy muajve të fundit kemi ngritur sindikatën në 20 kopshte të qytetit të Tiranës ku më parë arsimit.

Zv.Presidentja e SPASH, zj.Bukuroshe Shabani, e cila njëkohësisht është edhe kryetare e SPA Elbasan, u ndal në punën e mirë që po bëhet në këtë rreth për anëtarësimin e personelit të kopshteve në SPASH. Ajo u rindal, gjithashtu, në problemin më shqetësues që ka si kryetare e Sindikatës së Pavarur të Arsimit, për mos ndaljen e kuotizacionit të anëtarësisë së sindikatës në bordero nga ana e Degës



drejtursve sindikalistë në shkolla në të gjitha rrethet ku vepron SPASH. Ai theksoi se procesi zgjedhor, sipas informacioneve qe kemi, po ecen normalisht dhe në përputhje me detyrat e afatet e përcaktuara në mbledhjen e kaluar të Këshilit Kombëtar. Gjithashtu, ai rikërkoi nga të pranishmit nxitjen e sindikalistëve të bazës për të dhënë mendime në lidhje me përmirësimet e mundëshme në Statut dhe ne Kontratën e re Kolektive që do të nënshkruhet në fund të këtij viti.

Me pas, anëtarët e Këshillit Kombëtar të pranishëm në mbledhje, diskutuan mbi ecurinë e problemet e punonjësit nuk kanë qënë të organizuar në sindikatë.

Në ndërhyrjen e tij z.Bajram Kruja vlerësoi punën e mirë të dy drejtuesve të Tiranës, zotërinjve Haxhi Meçuli e Shaban Duka, dhe verejti se shembulli i tyre duhet të ndiqet edhe nga disa drejtues te SPA të rretheve, ku numri i të sindikuarëve është në përqindje të ulët, krahasuar me numrin e përgjithshëm të mësuesve në rreth. Motoja jone ne keto zgjedhje është:- "Cdo mësues duhet të jetë i sindikuar". Ndaj të gjithë duhet të punojmë për anëtarësimin e të gjithë atyre mësuesve që deri tani nuk bëjnë pjesë në asnjërën prej sindikatave të së Thesarit të rrethit. Me gjithë këmbënguljen e saj si kryetare e sindikatës, për ndalesën e kuotizacionit në bordero, e drejtë kjo e ligjëruar në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë dhe e nënshkruar edhe në Kontratën Kolektive të lidhur ndërmjet dy sindikatave të arsimit, (SPASH e FSASH), dhe Ministrisë së Arsimit dhe të Shkences, përsëri ngelet e pakuptueshme arsyeja përse Dega e Thesarit e Elbasanit bëhet pengesë, kur në të gjitha rrethet e tjera nuk ka asnjë shqetesim nga DAR dhe ZA per ndalesën e kuotizacionit ne bordero sipas deklaratave te anëtarësisë, ashtu siç është e

parashikuar edhe në Kodin e Punës.

Edhe ne Tropojë procesi zgjedhor ne shkolla po ecën normalisht - tha në diskutimin e tij kryetari i SPA të rrethit Z.Haxh Murathi. Nga 337 mësues gjithsej që janë në rreth, 231 prej tyre aderojnë ne SPASH dhe deri në Kongresin e V të SPASH do të punojmë që ky numër të shkojë në rreth 280 anëtarë.

Hyqmet Kaçaniku, kryetar i SPA Gramsh, u ndal në rolin që duhet të luajë sindikata për mbrojtjen sa më mirë të anëtarëve të saj, duke i'u referuar rastit të transferimit të një kryetare të sindikatës së një shkolle, pa marre mendimin e sindikatës, me arsyetimin se nuk ka arsimin e lartë. Gjithashtu, ai theksoi se kanë përfunduar zgjedhjet në 24 shkolla dhe jemi në vazhdim në shkollat e tjera. Në SPA Gramsh aderojne gjithsej 350 anëtarë më kuotizacion të rregullt.

Shumë mirë po ecën procesi zgjedhor edhe në shkollat e rrethit te Korçës, ku drejton nje nga sindikalistet më me përvojë, mesuesja e talentuar Albina Pepo, e cila qëndron në krye te SPASH-it persa i perket numrit të anëtarësisë dhe derdhjes se kuotizacioneve me 1150 anetare dhe që çdo ditë anëtarëson mësues të rinj në sindikatë.

Në diskutimin e tij z.Luan Zonja, kryetar i SPA Lushje, tha: Nuk është e lehtë të jesh në krye të një sindikate siç është sindikata e arsimit ne rreth, pasi hasim vështirësi dhe probleme të shumta në disa shkolla të veçanta, por, megjithatë, ndjen kënaqësi, kur punon mbi bazën e një kontrate kolektive si e jona, ku mesuesit ndihen të mbrojtur dhe besojnë në forcën e SPASH. Këtë e tregojnë edhe anëtarësimet në rreth 900 anëtarë që kemi deri tani dhe që deri ne fund të vitit 2009, në prag të lidhjes së kontratës së re kolektive, për të cilën mendoj se duhet ta përmirësojmë më tej, do të punojmë të arrijmë në 1100-1200 anëtarë, duke theksuar se në punën tonë kemi patur



mbështetjen e kryesisë se SPASH dhe të BSPSH në rreth.

Në arsim sot ka tre kontigjente mësuesish,-theksoi në fjalën e tij z.Shpëtim Sino, kryetar i SPA Fier: mësues anëtarë të SPASH-it, anëtarë të FSASH-it dhe indiferentët, me të cilët duhet të punojmë që edhe këta të fundit të anëtarësohën në sindikatë. Në lidhje me diskutimet mbi kontratën kolektive mendoj se ne kontratën e ardhshme duhet të përcaktohet qartë që, kur mesuesi,,anëtar i sindikatës, del ne pension, perfiton dy paga shpërblim dhe jo deri ne dy paga shperblim, pasi me kete eshte abuzuar dhe të pakta janë rastet kur mesuesit kanë përfituar dy paga.

z.Dëfrim Spahiu, Zv/President i SPASH-it, gjatë ndërhyrjeve të tij, theksoi nevojën e shfrytëzimit të periudhës zgjedhore për shtimin e numrit të të anëtarësuarëve, sidomos në rrethet e Malësisë se Madhe, Beratit, Gjirokastrës etj, ku, sipas diskutimeve të z.Binak Jocaj, Joli Papa e Roland Çomo, u vu re që numri i të anëtarësuarëve është relativisht i ulët, krahasuar me numrin e përgjithshëm të mësuesve në rrethe. Gjithashtu, ai theksoi se është e domosdoshme që Kryesia e SPASH dhe departamenti i organizimit të bëjnë çështë e mundur që deri në nënshkrimin e kontratës kolektive, të riorganizohet sindikata në rrethet Kavajë, Kukës, Sarandë, Përmet dhe Skrapar.

Edhe në diskutimet e z.Aleks Dushi, Gjergji Treska, Arben Kola, Pjetër Prenga, Valbona Ago, Afërdita Myzyri, respektivisht kryetarë të SPA Shkodër, Pogradec, Burrel, Lezhë, Ersekë e Librazhd,u evidentua puna e mire që po bëhet për zgjedhjen e drejtuesve sindikalistë ne shkolla, në përputhje me statutin e SPASH dhe kerkesat e partneritetit me DAR dhe ZA në zbatim të kontratës kolektive.

Në përfundim z.Bajram Kruja, President i SPASH-it, pasi falenderoi të pranishmit për punën e bërë, kërkoi edhe njëherë plotësim të saktë të dokumentacionit, tërheqjen e mendimeve të sindikalistëve në shkolla, për ndryshimet e nevojshme në Statut dhe përmirësimin e kontratës se re kolektive, si dhe çdo kryetar rrethi të njoftojë një javë përpara datën e zhvillimit të konferencës për zgjedhjen e kryetarit të SPA të rrethit, me qëllim monitorimin e të gjitha konferencave zgjedhore nga kryesia e SPASH.

Nevrus Kaptelli
Departamenti i Organizimit dhe i Mardhenieve me Publikun në SPASH

Vlerat sindikaliste

(Rreth ecurisë së fushatës zgjedhore në Këshillat Sindikale të FSASH në Pogradec)

Në rrethin e Pogradecit fushata zgjedhore në Këshillat Sindikale të shkollave dhe Institucioneve parashkollore, ka hyrë tashmë në një fazë intensive. Formatimi i strukturave drejtuese në kontekstin zgjedhor po trajtohet me të gjithë vëmendjen që meriton për gjallërimin e mëtejshëm të lëvizjes sindikaliste në komunitetin mësimdhënës dhe atë ndihmës.

Kanë përfunduar zgjedhjet e kryesive dhe kryetarve të Këshillave Sindikale në 15 Institucione arsimore në të cilat janë rikonfirmuar në vjeçare Bishnicë, Debrovë dhe Slatinë u zgjodhën drejtuesë të rinj mësuesit Bujar Balliu, Astrit Lufo, Mustafa Isufi etj. Zgjedhjet vazhdojnë në Institucionet e tjera arsimore sipas programit zgjedhor dhe grafikut të hartuar nga Seksioni Sindikal i rrethit. Në këtë proces nuk kemi lënë jashtë vemendjes shkollat private të arsimit jopublik që në rrethin tonë zënë një pjesë të konsiderueshme të shkollimit. Në shkollën e mesme " Lasgush Poradeci " të arsimit jo publik u zgjodh kryetar i organizatës sindikale mësuesi i talentuar Andi Kishta.



detyrën e drejtuesve 11 kryetarë. Kështu në shkollën 9 - vjeçare Homezh u rizgjodh z. Vladimir Shtupa, Gështenjas z. Syrja Capollari, "Koli Gusho" në qytet znj. Edmonda Turshinka, në shkollat e mesme Blacë znj. Mimoza Hamzallari, Proptisht z. Feim Oparaku, " Muahrrem Çollaku " Pogradec z. Bardhyl Hyka etj.

Në shkollat e mesme " 14 Engjëjt " Buçimas, Trebinjë dhe shkollat 9 -

Me pak përjashtime mbledhjet zgjedhore janë ndjekur nga antarët e kryesisë së Seksionit tonë sipas grafikut të fiksuar në programin zgjedhor. Deri tani kryetarët dhe antarët e kryesive të Këshillave Sindikale janë zgjedhur mësuesë me arsim të lartë pedagogjik dhe figurë të nderuar në komunitetet e shkollave, si një garanci për funksionimin normal të tyre në të ardhmen. Në kriteret e brendshme Seksioni ynë e vuri kusht arsimin e lartë të kryetarve të rinj, ndërsa antarët e kryesive mund të zgjidhen edhe mësuesë me arsim të mesëm të profileve pedagogjike që kanë rezultate të larta dhe figurë të konsoliduar në komunitet.

Fushata zgjedhore po i shërben sensibilizimit të opinionit pedagogjik të rrethit në kahun e shërbimit sindikalist dhe përfitimet e anëtarsimit në Federatën e Arsimit për mbrojtjen e interesave të tyre themelore. Përreth këtij objektivi parësor është përqendruar Seksioni Sindikal dhe strukturat drejtuese të organizatave gjatë kësaj periudhe.

Arsyet e këtij angazhimi primar janë të argumentuara përballë gjendjes konkrete të funsionimit të strukturave sindikale në shkolla.

Në opinionin e disa komuniteve mësuesish zotëron prej vitesh një indiferentizëm i pajustifikuar për vlerat dhe rolin e sindikatave në një shoqëri moderne demokratike. Koncepti i vjetëruar tashmë i nënvlerësimit të këtyre strukturave u heq atyre mbrojtjen e vetme nga punëmarrësit shtetërorë e privatë të cilët mund t'i largojnë nga puna kur të duan e si të duan, apo t'i trajtojnë në mënyrë arbitrare në komponentët e tjera të punës, si pagat, lëvizjet e pamotivuara etj. Sindikatat janë zëri i punonjësve, jane organizata ku merren vendime që lidhen me mbrojtjen e interesave të tyre në të gjitha përbërëset e marrdhënieve të punës.

Pasojë e kësaj mospërfilljeje është jeta e vakët e disa organizatave, numri i pakët i anëtarsimit deri në pamundësinë e ngritjes së tyre si në shkollat " Gjok Shqiptari " dhe "Enver Qiraxhiu " në qytetin e

Pogradecit, shkollat 9 - vjeçare Lin, Mëmlisht, Dardhas etj.

Seksioni ynë dhe kryesitë e Këshillave Sindikale në shkolla kanë punuar intensivisht dhe në mënyrë të kualifikuar për njohjen e legjislacionit të punes në mbrojtje të intersave të mësuesve, veçanërisht zbërthimin e Kontratave Kolektive të dy niveleve.

Në kohën e sotme provohet katërcipërisht se sistemi i ekonomisë së tregut është organizimi shoqëror më i mirë, më efiçent dhe më racional. Rentabiliteti i këtij sistemi ka një dimension të natyrshëm dhe të pakundërshtueshëm; është më afër realitetit njerëzor, natyrës së shoqërisë, është në koherencë të plotë me atë, që në filozofi quhet logjika e sendeve. Aspirata e vendit tonë për të ndërtuar këtë strukturë është sa e ëndërruar aq edhe e largët për një varg të tërë arsyesh.

Një nga Presidentët amerikanë, në mesin e shekullit XX, deklaronte:

"Modeli amerikan i ekonomisë, në fushën e marrdhënieve të punës, mbështetet në dy shtylla, punëdhënësit dhe punëmarrësit. Shteti ka për detyrë të rregullojë me ligj marrdhëniet midis tyre, si një nga parimet bazë të demokracisë reale"

Sipas këtij këndvështrimi, sindikalizmi është komponet esencial i sistemit të ekonomisë së tregut, ku sindikatat luajnë rol kyç dhe të pazëvendësueshëm nga asnjë mekanizëm tjetër.

Në legjislacionin shqiptar të viteve të fundit, që nga Kushtetuta, Kodi i Punës dhe një sërë aktesh të tjera nënligjore, në fushën e marrdhënieve të punës, janë realizuar arritje që e kanë përafruar atë me legjslacionin e demokracive të vjetra e më të përparuara të Europës. Kontrata Kolektive e Punës e korrikut 2006 përbën një arritje serioze të lëvizjes sindikaliste. Përpjekjet për zbatimin e saj në rrethin tonë kanë qënë efektive megjithë kundërshtitë e strukturave punëdhënëse në rreth e në qendër.

Një shembull i qartë i forcës sindikaliste dhe Kontratës Kolektive ishte mbrojtja ligjore e një numëri të madh mësuesish të larguar nga puna vitin e kaluar. Seksioni Sindikal i rrethit atakoi publikisht dhe në rrugë institucionale Udhëzimin e Ministrit të Arsimit për largimin e mësuesve me arsim të mesëm pedagogjik, nismë që u përkrah fuqimisht nga FSASH. Përfundimi ishte diferencimi i mësuesve me diplomë të shkollës së mesme pedagogjike dhe rikthimi i tyre në punë. Në rrethin tonë ky kontigjent kapi shifrën e 40 mësuesve.

Ndërkohë 34 mësuesë të tjerë me arsim të mesëm pedagogjik me dëftesë pjekurie, të larguar nga puna, e çuan në gjyq çështjen dhe e fituan në të dy shkallët e gjykimit të rrethit gjyqësor Korçë. Aktualisht Zyra Përmbarimore e rrethit po vjel fondet e Zyrës Arsimore për dëmshpërblimin e tyre. Ky veprim ligjor rriti besimin e mësuesve në mbrojtjen sindikaliste nga Federata. Si pasojë, u fuqizuan me antarë disa organizata në shkollat Gështenjas, Buçimas, Blacë dhe u ngritën organizata të reja në shkollën e mesme Trebinjë, Velçan dhe Bishnicë.

Megjithëse jo me të njëjtin rezultat, Seksioni Sindikal i rrethit tonë nuk ka lejuar lëvizjen nga vendi i punës të drejtuesit të Këshillave Sindikale me përjashim të rasteve të veçanta të argumentuara. Në këto përpjekje kemi ndjerë afër inkurajimin dhe dorën e FSASH – it, siç ishte rasti i lëvizjes së pamotivuar të kryetarit të Seksionit, që u rikthye brenda tre javësh.

Një difekt i punës sonë që mendojmë të jetë objektiv i së ardhmes është zbatimi i nenit respektiv të KK që parashikon heqjen e klasës në kujdestari për kryetarët e Organizatave sindikale të shkollave që plotsojnë numrin e nevojshëm të anëtarsisë. Kjo klauzolë do të rritë interesimin e të zgjedhurve të rinj në këtë fushatë dhe do të motivojë angazhimin për fuqizimin e lëvizjes sindikaliste të Federadës në rreth.

Kemi kërkuar nga ZA njohjen dhe respektimin e Kontratës Kolektive, si një detyrim ligjor por edhe si një ndihmë e pazëvendësueshme për zbatimin e programit shtetëror për arsimin. Pavarsisht ngë luhatjet, marrëdhëniet midis ZA dhe Federatës së Arsimit në rrethin tonë kanë shënuar progres. Një sërë problemesh të reformës arsimore janë zgjidhur në partneritet midis palëve. ZA ka bërë prezente problematikën e saj në seksionin tonë përmes dokumentacionit apo mbledhjes me drejtorët e shkollave etj. Disa çështje të reformës janë diskutuar midis palëve dhe kanë marrë zgjidhje të pranueshme. ZA ka marrë në konsideratë argumentat e seksionit tonë, ndonse shpesh ka devijuar nga marrveshjet e arritura. Ne gjykojmë se ky bashkëpunim duhet të zgjerohet më tej në të gjithë komponentet e KK, jo vetëm thjesht si një detyrim ligjor, por se ky bashkëpunim do të çojë në një rezultante të përbashkët për të dy partnerët; progresin e arsimit dhe shkollës në rrethin tonë.

Duke shfrytëzuar mundësinë që na jep Revista, u bëjmë thirrje të gjithë mësuesve dhe punonjësve jomësimorë të rrethit tonë të anëtarsohen në organizatat sindikale të Federatës së Arsimit për të fuqizuar me tej sindikaten, per te siguruar nje mbrojtje te plote, për të ruajtur dinjitetin e tyre dhe për të qënë partnerë dinjitozë në të gjitha zhvillimet dhe reformat e arsimit ne rrethin tonë.

Istref Haxhillari
Kryetar i Seksionit Sindikal
të FSASH-it Pogradec

Nga veprimtaria e Sindikatave te Arsimit ne hapesiren shqiptare

KONGRESI I 5-te I SBASHK-ut TE REPUBLIKES SE KOSOVES

Me 4 prill 2009, ne Prishtine, zhvilloi punimet Kongresi i 5-te i Sindikates se Bashkuar te Arsimit, Shkences dhe Kultures se Republikes se Kosoves. Ky ishte Kongresi i pare i kesaj sindikate ne Kosoven e pavarur.

Ne punimet e Kongresit moren pjese edhe Ministri i Arsimit, Shkences dhe Teknologjise se Kosoves, z. Enver Hoxhaj, zv/Ministri i kesaj ministrie dhe ish kryetar themelues i SBASHK-ut, z. Agim Hyseni, kryetaret e te dy Sindikatave te Arsimit te Shqiperise Xhafer Dobrushi dhe Bajram Kruja, delegacioni i Sindikates Holandeze te Arsimit, AOb, i perbere nga Kryetari z Walter Drecher dhe sekretarja nderkombetare zj. Trudi Kerperien si dhe delegacione te sindikatave te arsimit nga Sllovenia dhe Maqedonia.

Ne fjalen hyrese ne Kongres, Kryetari i SBASHK-ut z. Ali Shabani, theksoi se " eshte kënaqësi të jemi sot së bashku në Kongresin e V të SBASHK-ut, në Kongresin që i zhvillon punimet në shtetin e pavarur të Kosovës, një ëndërr dhe një dëshirë e realizuar, një përjetim krejt ndryshe, një realitet që e njohu dhe po e njeh e tërë bota, një perspektivë e të gjithë qytetarëve që jetojnë në të, një vend i paqes dhe prosperitetit, një vend ku frymojnë dhe zhvillohen lirshëm kultura dhe arsimi si elemente të shenjta dhe dalluese të çdo komuniteti, në këtë takim të radhës ku të gjithë ndihen të lirë, reflektojnë lirshëm për problemet që na preokupojnë por dhe do të marrim vendime për të mirën e mësimdhënësve, nxënësve dhe studentëve. Historia len gjurmët e saj të mira dhe problemore. Kosova është e mbarsur me të tilla gjurmë, por e vendosur të ecë përpara në rrugën e civilizimit…".

Mbasi analizoi veshtiresite dhe ballafaqimet e sindikates me punedhenesin qe nga viti 2004 e ketej, ku SBASHK-u jo vetem ka rezistuar por ne shume aksione edhe ka fituar, z. Ali Shabani vleresoi marredheniet e mira dhe partneritetin real me Qeverine Thaci dhe Ministrin Hoxhaj, sidomos ne miratimin e nje sistemi te ri te pagave qe ka realizuar fazen e pare te licensimit sipas pergatitjes profesionale dhe pervojes se punes, pergatitjet per fazen e dyte te licensimit, ndertimin e sistemit te ri te trajnimit te mesimdhenesve, permiresimin e kushteve te punes dhe zgjerimin e vellimit te lirive sindikale, etj.



Ai theksoi gjithashtu se MASHT dhe Qeveria përfundimisht e kanë kuptuar se dialogu social është komponent kyç i ndërtimit të proceseve demokratike. Rezultat i ketij partneriteti eshte pergatitja e Kontrates se re Kolektive te Punes teksti i se ciles ka kaluar per diskutim publik dhe se shpejti do t'i dorëzohet MASHT-it. Pas negocimit mendojmë që të dy palët ta firmosin Kontraten për t'i dhënë rrugë bashkëpunimit gjithnje më të mirë të një partneriteti të dëshmuar deri tani.

Federata e Sindikatave te Arsimit dhe Shkences dhe Sindikata e Pavarur e Arsimit Shqiptar i drejtuan Kongresit te 5-te te SBASHK-ut nje pershendetje te perbashket, ne te cilen shprehej me ngrohtesi e realizem vleresimi i larte per rrugen historike qe ka kaluar Sindikata e Arsimit te Kosoves per mbrojtjen dhe zhvillimin e arsimit e te kultures kombetare, ne gjithe proceset demokratike dhe ne luften per liri e pavaresi. Ne pershendetje shprehej besimi se te tre sindikatat shqiptare do t'i ruajne dhe forcojne me tej marredheniet dhe bashkepunimin midis tyre ne funksion te ndertimit e konsolidimit te nje sindikalizmi bashkekohor ne kuadrin e Konfederates Sindikale Boterore dhe Europiane te Arsimit, anetare te te cilave jane te tri sindikatat shqiptare.

Kongresin e pershendeti edhe Ministri i Arsimit, Shkences dhe Teknologjise se Kosoves, z. Enver Hoxhaj. Ai parashtroi vecanrisht vizionin e Qeverise Thaci per zhvillimin e arsimit ne Kosoven e pavarur dhe garantoi se ne arritjen e ketyre objektivave Ministria qe ai drejton do te punoje ne partneritet te vazhdueshem me SBASHK-un.

Korresp. i "TRIBUNA SINDIKALE"

Strategjite dhe veprimet e sindikatave te arsimit per pagat ne kushtet e krizes globale

(Disa konkluzione te Konfederates Europiane te Sindikatave te Arsimit, ETUCE)

Kriza financiare qe ka perfshire vendet kryesore te botes eshte me e thella dhe me e veshtira qe ka njohur njerezimi qe nga vitet 30-te. Vendet kryesore kapitaliste duke filluar nga SHBA, Anglia, Gjermania, Japonia, Kanadaja, Franca, Italia jane perfshire nga kjo krize. Por vendet e Europes Qendrore e Lindore, per shkak te brishtesise se ekonomive te tyre, qe sapo kane kaluar fazen e tranzicionit, jane me te ndikuara dhe te rrezikuara. Nga studimet qe ka bere Bashkimi Europian rezulton se deri tani, qe konsiderohet faza e pare e krizes, pak me te "sigurta" dhe te qendrueshme duken ekonomite dhe financat e vendeve lindore anetare te BE si Polonia, Sllovakia, Polonia dhe Republika Ceke.

Nga vendet lindore anetare te BE ne " zonen e rrezikut" jane Estonia, Lituania, Letonia dhe Hungaria. Ne kete "zone rreziku" ben pjese edhe Ukraina, e cila nuk eshte anetare e BE. Ndersa Bullgaria dhe Rumania kane filluar te ndikohen nga kriza.

Po pse themi se kriza financiare ne vendet e Europes Qendrore e Lindore sjell pasoja me te egra se ne perendim? Kjo per shkak se Bankat e ketyre vendeve kane marre hua nga Bankat Perendimore vetem qe nga viti 2002 rreth 1.500 miliard dollare. Ne kushtet e krizes, qe shoqerohet me uljen e ritmeve te zhvillimit, vendet lindore e kane shume te veshtire te perballojne shlyerjen e borxheve qe kane marre, sepse kthimi i borxhit ndikon drejtperdrejt ne rritjen e inflacionit, ne dobesimin e monedhave vendase kundrejt monedhave te forta perendimore, ne rritjen e cmimeve te artikujve te konsumit, vecanrisht te artikujve jetike, ne renien e cmimit te pronave, etj. Ne disa nga keto shtete lindore monedha vendase eshte cvleresuar nga 20-30 perqind, ndersa cmimet e pronave kane rene deri ne 20 perqind.

Aktualisht shume nga keto shtete te Europes Qendrore e Lindore po rishikojne dhe po bejne shkurtime ne buxhetin e vitit 2009, duke ulur investimet por edhe duke shkurtuar pagat e punonjesve buxhetore, perfshire edhe pagat e mesuesve. Ne Letoni pagat e mesuese u ulen me 25 perqind, per te ruajtur te paprekur numrin e vendeve te punes, ndersa ne Lituani, si rezultat i ketyre zhvillimeve, po ndodhin crregullime sociale.

Ne keto kushte, Konfederata Europiane e Sindikatave te Arsimit, ETUCE, po perpunon nje sere masash, per t'u ardhur ne ndihme organizatave sindikale anetare, masa te cilat i ka diskutuar dhe vazhdon t'i diskutoje me Bashkimin Europian, per te lehtesuar efektet e krizes dhe pasojat e saj ne sektorin e arsimit. Qellimi i ETUCE eshte qe t'i beje te njohura keto perpjekje dhe programe, qe te terheq ne kohe vemendjen e sindikatave te arsimit ne mbare Europen per te krijuar nje front te fuqishem sindikal qe te ushtroje presion mbi Bashkimin Europian ne teresi dhe ne cdo vend anetare ose kandidat te tij vec e vec, per te mos prekur buxhetet per arsimin dhe per te garantuar me shume fonde per kete sektor ne paketat financiare qe BE miraton per perballimin e krizes.

Cfar duhet te mbaje parasysh ne keto momente levizja sindikale ne arsim ne shkalle Europiane dhe sindikatat ne nivel kombetar ?

Me rendesi eshte qe zhvillimet te mos ia leme spontaneitetit, qe te mos mbyllim syte para krizes financiare dhe rrezikut te saj, por te parashikojme masa, kerkesa dhe aksione qe i zbutin efektet e krizes ne secilin vend. Sindikatat duhet te jene te pergatitura per te pranuar se sistemi financiar nuk do ta kaperceje lehte krizen dhe se besimi ne kete sistem nuk mund te rivendoset sa hap e mbyll syte. Kriza financiare eshte nje proces qe ka ne themel disa ligjesi objektive qe karakterizojne gjithe etapat e zhvillimit te tij. Prandaj nuk na lejohet te mendojme se kaq shpejt kriza ka arritur pikun dhe rreziku po kalon. Ne shkalle boterore, por edhe Europiane, ajo eshte akoma duke u zhvilluar derisa te arrije periudhen e stanjacionit. Dhe derisa te vije etapa e ringjalljes se ekonomive dhe shendoshjes se sistemit financiar duhen edhe nje, dy ose ndoshta edhe 3 vjet. Prandaj nuk duhet te ushqejme iluzione. Te kuptohemi, nuk eshte rasti per te ngjallur panik dhe per te trembur njerezit, por per te ndergjegjesuar sindikalistet dhe sindikatat qe t'a ndjekin me vemendje dhe hap pas hapi procesin e krizes dhe pasojat e saj me qellim qe te lehtesohen e pakesohen efektet negative ose edhe shkatrruese qe kriza prodhon.

Sindikatat duhet te negocojne me qeverite e tyre, me ministrite e edukimit, me organet e pushtetit vendor, per te ndikuar qe ne rast rreziku, buxhetet e arsimit te preken te fundit, qe vendet e punes te mesuesve te mos shkurtohen.

Eshte momenti qe sindikatat e arsimit dhe mesuesit t'i japin me shume vend dhe vlere parulles se " te mesuarit gjate gjithe jetes". Miliona te rinj ne Europe vuajne pasojat e papunesise, ne nje kohe kur ne shume vende, sidomos lindore, ekziston ne shifra te larta sektori informal dhe perdoret puna e femijeve. Shpenzimet per shkollimin dhe kualifikimin e rikualifikimin e ketyre te rinjve eshte investimi me frutdhenes per prodhimin, per ringjalljen dhe forcimin e ekonomise, per uljen e papunesise.

Gjate periudhes se krizes jo vetem nuk duhet te zbehet, por duhet te intesifikohet dhe te behet me real dhe efektiv dialogu social. Kur jane momentet qe negocohet per te nenshkruar kontratat kolektive te punes ne te gjitha nivelet, ose kur sindikatat negocojne per permiresimin e kontratave ekzistuese, problemet dhe faktoret qe lidhen me efektet e krizes financiare duhet te jene paresore. Ne kete proces negocimi sindikatat e arsimit duhet te insistojne dhe argumentojne se ne arsim nuk duhet te behen shkurtime te vendeve te punes, si rezultat i pasojave te krizes, se pagat e mesuesve jo vetem te mos ulen, por te permiresohen e rriten vazhdimisht.

I domosdoshem eshte dhe mbetet bashkepunimi i Sindikatave te Arsimit me sindikata te degeve dhe profesioneve te tjera si dhe me aktore te shumte te shoqerise civile e shoqata te ndryshme, me komunitetin e prinderve dhe nxenesve, per te krijuar nje Front te fuqishem ne mbeshtetje te shkolles e mesuesve, ne mbeshtetje te levizjeve per nje arsim cilesor dhe te mesuarit gjate gjithe jetes.

SYNIMI I TË GJITHËVE: ASNJË NXËNËS I LARGAUR NGA MËSIMI

(Përvojë nga puna e sindikalistëve, në shkollën 9-vjeçare "Kamza e Re",Tiranë)

1.

Në dalje të qytezës së Kamzës, kur shkon për në Fushë-Krujë, duhet të ecësh pak në të majtë që të arrishë në shkollën 9-vjeçare "Kamza e Re". Nuk di se përse e kanë lënë pa një emër tjetër, kur dihet se janë më dhjetëra e qindra ngjarjet historike dhe personalitetet, me të cilat ajo mund të pagëzohej. Megjithatë, nuk ka ndonjë rëndësi të madhe kjo gjë për qëllimin e vizitës sime aty. Kryesorja, vlen të shënohet se kam marrë një kërkesë nga revista "Tribuna Sindikale", për të bërë një shkrim për kolektivin e saj mësues-nxënës, pasi e meritojnë plotësisht.

Sapo përballem me pamjen e jashtme të kësaj shkolle, befasohem. Kështu mund të them dhe për ndërtesën e kopshtit të fëmijëve, që ësthë ngritur aty pranë. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për mjediset e brendshme të tyre, korridoret, klasat, kabinetet etj. Kudo të bie në sy rregulli, pastërtia dhe estetika. Është mësim dhe asgjë nuk dëgjohet, veç zërit të mësuesve ose të nxënësve, që përgjigjen. Por dhe kur bie zilja e mbarimit të orës së mësimit, përsëri nuk ka rrëmujë ose zhurma, siç e ndeshim jo rrallë në shkollat tona. Me një fjalë, ndien kënaqësi se do të njihesh me jetën e këtij kolektivi mësues-nxënës.

2.

Së pari, takohem me kryetarin e sidikatave të arsimit të zonës, pra që përfshin disa shkolla, mësuesin Mersin Terpo. Me përkushtimin e tij, kështu ka marrë përsipër dy detyra të rëndësishme ose, siç thotë populli, "ka dy kunguj në një sqetull", atë shtetërore, pra të mësimdhënësit dhe një tjetër po kaq të rëndësishme, si veprimtar i dalluar shoqëror. Ai nxiton të tregojë, me gojën "bilbil", për jetën dhe veprimtaritë e sindikalistëve.

"Fushat e veprimtarive tona janë të shumta,-tregon Mersini.-Ja, po përmend ndonjërën nga ato: puna e të gjithëve e bashkëpunimi me drejtuesit e shkollës për arritje sa më të larta në procesin mësimor-edukativ; puna për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe të rikthimit të nxënësve të larguar; vëmendja për nxënësit me probleme të ndryshme, si shëndetësore, ekonomike etj; përgatitja dhe zhvillimi i veprimtarive të ndryshme, brenda e jashtë shkollës etj". Tashmë, të gjithë jemi të ndërgjegjsëhm se, gjatë periudhës së tranzicionit, në shkollat tona ka lindur një problem mjaft i mprehtë, shtetëror e shoqëror, ai i braktisjes së shkollës. Sindikalistët e arsimit të Kamzës, duke siguruar bashkëpunim e bashkëveprim me drejtuesit e shkollave dhe tërë mësuesit, si dhe me prindërit e mbarë komunitetin, kanë mundur që ta parandalojnë hap pas hapi këtë dukuri të rëndë, që sjell pasoja të padëshiruara, njëra nga të cilat është shtimi i analfabetëve.

Z. Mersin Terpo më tregon përvojën e çmuar, që kanë fituar në



këtë drejtim. Po si kanë vepruar konkretisht ata? Vitin e kaluar në këtë shkollë, për shembull, ishin 54 nxënës, që e kishin braktisur mësimin. Arsyet ishin nga më të ndryshmet, ndër të cilat përmendim: gjendja e vështirë ekonomike, gjakmarrja e lidhur me ngujimin e fëmijeve, divorcet e prindërve dhe fëmijët e familjeve me ngjyrë etj. Më të shumtit, nxënësit braktisës ishin nga klasat e 8-ta. Pas evidentimit të rasteve, një për një, u ngrit një komision sindikal dhe në zonë, në të cilën bënë pjesë mësuesit Kujtim Hodo, Ermira Nika, Arben Canku, Donika Berisha e Drita Zeza. Ndërsa në çdo klasë të kësaj shkolle u ngritën grupe të vopgla, me mësuesen kujdestare dhe 3 nxënës. Pastaj ata shkuan familje më familje dhe biseduan me qetësi e takt pedagogjik, që mos të lëndonin njeri, por dhe të arrinin që ata fëmijë të riktheshehin në bankat e shkollës.

Secili rast ka "historinë" e tij. U njoha me njërin prej tyre. Një nxënëse e klasës së 8-të e kishte babain në burg dhe, për këtë shkak, ajo e ndërpreu shkollën. Se i duhej të kujdesej dhe për vëllezërit e motrat e saj. Mësuesja kujdestare, Afroviti Pasho, mori me vete nxënësen-senatore, Valbona Muja dhe shkuan në atë familje. Biseduan shtruar me nënën e vajzës dhe arritën që t'i bindin të dyja, që ajo të bashkohej me të tjerët. Sigurisht, kënaqësinë e gëzimin e kësaj arritjeje e përjetuan të gjithë në klasën e tyre.

Kurreshtja ime ishte të dija shifrat, pra se çfarë u arrit konkretisht me këtë aksion, i cili vazhdon dhe në ditët e tanishme. Kështu, deri tani, si rrjedhojë e organimzimit të mirë të punës, është arritur që të rikthehen në bankat e shkollës 13 nxënës. Por, natyrshëm, nuk janë të vetëkënaqur. Përkundrazi, synimi i të gjithëve është që asnjë nxënës mos të jetë i larguar nga shkolla.

Por është dhe një rast i një natyre tjetër. Një nxënëse kishte vështirësi në të folur. Ditët e para, mezi erdhi në shkollë. Se i vinte dhe turp nga shoqet e shokët e klasës. Për ta qetësuar atë, si dhe prindërit, mësuesi kujdestar bisedoi me kolektivin e klasës, që ta zgjidhnin sa më mirë këtë çështje. Të gjithë dhanë fjalën se do të ishin shumë të kujdesshëm me shoqen e tyre dhe se do ta ndihmonin me durim e takt. Mësuesi bënte punë të diferencuar me të dhe nxënësit e mabanin afër. Tani ajo nxënëse e ndien vetem mirë dhe përparon, përkrah të tjerëve.

Mersini më tregon se dhe në shkollën-pilot të Valiasit punohet po me këtë praktikë pune, për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe rikthimin e nxënësve të larguar. Në krye të kësaj pune është veprimtari i dalluar i sindikatës së arsimit, Tafil Ibro. Kështu, me punë këmbëngulëse atje u arrit që, nga 57 nxënës braktisës, të kthehen në shkollë 10 prej tyre dhe synojnë që këtë shifër ta zvogëlojnë.

3.

Në shkollën 9-vjeçare "Kamza e Re" gjen disa fakte, që meritojnë të përmenden. Ndër të tjera, është ngritur e po pasurohet vazhdimisht biblioteka (me kujdesin e mësuesit Kujtim Hodo dhe është ngritur këndi museo (nga mësuesit Dilaver Dervishi e Gentjana Meço). Po kështu, funksionon kabineti i informatikës, me 10 kompjutera dhe me mësuesit do të bëhet një kurs i shkurtër për përdorimin e tyre. Ndër veprimtaritë e zhvilluara kanë qenë: ekspozita e arteve figurative (me kujdesin e mësuesit Besnik Hoxha), konkursi për krijimtarinë letrare e recitimet etj. Tani nxënësit e klasës së 8-të po përgatisin të venë në skenë komedinë "Karnavalet e Korçës" etj.

Ditët e muajt ecin një e nga një dhe po shkojmë drejt përfundimit të këtij viti arsimor. Drejtori i kësaj shkolle, Zylfi Spata, më tregon se afër 1.500 nxënësit dhe rreth 90 mësuesit e saj, janë të përkushtuar plotësisht. Pëkrah tij janë dhe drejtuesit tjerë, Violeta Cara, Astrit Lala e Roza Zefi. Objektivi i të gjithëve është që ta ngrenë më lart shifrën e kalueshmërisë dhe të notës mesatare, në krahasim me vitin ansimor që kaloi. Për këtë gjë, parashikimet janë pozitive, pasi dhe në simestrin e parë arritjet ishin më të mira se vitin e shkuar.

Pozitive është, kur bindesh se, në tërë jetën dhe veprimtarinë e kësaj shkolle dhe të tjerave në zonë, është siguruar një bashkëpunim dhe partneritet i mirë ndërmjet sindikatave të arsimit dhe drejtuesve të shkollave. Objekt i përbashkët ka qenë zgjidhja e shqetësimeve të ndryshme të sindikalistëve, si: ngarkesa mësimore, paga, gjendja familjare e shëndetësore; kujdesi për parandalimin dhe zhdukjen e punës së fëmijëve; organizimi i veprimtarive kulturore-artistike dhe i ekskursioneve të ndryshme, pjesëmarrja në ngjarjet familjare të njëri-tjetrit etj.

…Kur po largohesha nga kjo shkollë, drejtori më kërkoi të falur që po ndahej nga unë, pasi aty arritën disa zyrtarë. Ata do të shikonin gjendjen e mjediseve tëb jashtme, se si mund të ndihmonin që ato të bëhëshin sa më funksionale për nxnënësit e mësuesit. Meraku i tij ishte i natyrshëm, prandaj u ndava me të dhe me përfaqësuesin e simndikatave të arsimit, duke ju uruar arritje sa më të mira në procesin mësimor-edukativ.

MURAT GECAJ

Të reja shkencore

INTERNETI I ORBITËS

Në hapësirë, askush nuk mund t'ju dëgjojë kur bërtisni. Por do të jeni në gjendje të dërgoni e-mail, në sajë të një protokolli të ri që po



përpunohet dhe është pothuajse gati për t'u përdorur në hapësirë. Është e vështirë të mbahet një lidhje e qëndrueshme në orbitë, kështu që Interneti ndërplanetar do të duhet të falet për vonesat dhe ndërprerjet.

Në shtator, një satelit përdori protokollin e ri për të dërguar imazhe në Tokë.

"VJELËSI" BIOMEKANIK I ENERGJISË

Energjia që përdorim është shumë e pranishme në shekullin e 20-të. Energjia elektrike është kudo rreth nesh, mjafton të dimë si ta përdorim. Kjo motivoi Max Donelan për të shpikur një pajisje që "vjel" energjinë e të ecurit. Pajisja vendoset rreth gjurit dhe gjeneron energji, duke përdorur të njëjtin parim që lejon makinat hibride të riciklojnë energjinë që krijohet nga frenimi. Një këmbësor që ka vendosur "vjelësin"



në të dy gjunjët mund të gjenerojë rreth pesë vat energji - e mjaftueshme për të karikuar 10 telefona celularë - pa penguar ecjen me hapa të shpejtë. Pajisja e Donelan është ndoshta më e rëndësishmja, në një klasë të tërë produktesh të "vjeljes" së energjisë, në një kohë kur teknologjia portabël si iPod dhe Blackberry është bërë gjithnjë e më shumë e pranishme. Asnjë vat nuk humbet.

KULLA DINAMIKE

Secili nga 80 katet në grataçelin e parë në botë që lëviz, me zyra dhe një hotel, si edhe me apartamente në majë, rrotullohet me 360 gradë, secili me shpejtësi të ndryshme. I dizenjuar nga arkitekti italian David Fisher dhe i ndodhur në Dubai,(një tjetër është planifikuar për në Moskë), kulla do të kushtojë rreth 700 milion USD. Banesat do të shiten nga 3,7 milion USD deri në 36 milion USD. Ndërtesa duhet të përfundojnë në 2010.



Këshilla praktike

ARTI I TË BËRIT KOMPROMIS

Kur fëmijët mësojnë të negociojnë, shtëpia bëhet një vend i qetë dhe i lumtur . Pothuajse çdo situatë në jetë që përfshin dy ose më shumë njerëz është një kompromis mes palëve me interesa konkurruese. "Fëmijët e dinë këtë me intuite" thotë Doktori i Shkencave, Daniel Shapiro.

Por natyrisht, kur ke të bësh me fëmijë, duhet të jesh i prirur drejt lëshimeve të vogla, duke mbyllur një sy për të arritur në shpërblime më të mëdha.

Fëmijët të cilët nuk mësohen që të negociojnë rriten dhe kthehen në persona madhorë që nuk dinë si të përballojnë një konflikt.

"Të qënit prind është në thelb të jesh negociator i mirë dhe menaxhues stresi," thotë Shapiro. "Në qoftë se keni aftësitë negociuese, stresi juaj do të jetë më i paktë.

Negocioni me kokë jo me zemër

Fillimisht fëmija duhet qetësuar, zakonisht me një përqafim dhe me një kërkesë për të mbledhur veten, duke u sjellur sikur ai të ishte i madh, në mënyrë që të mund të kuptohet ajo që ai po përpiqej të thoshte. Edhe më e rëndësishme, thotë Braun, është të mbash nën kontroll emocionet. Çdo gjë që mund të thoni në momentin kur jeni i nxehur, mund të ketë efekte afatgjata, të cilat nuk i keni parashikuar.

Dorëzoni disa territore

Fëmijëve u pëlqen të kenë disa mundësi zgjedhje, sepse kjo u jep atyre ndjesinë e kontrollit. Ata duan të ushtrojnë vullnetin e tyre. Në gjysmën e situatave të krizave, Shapiro thotë se, "fëmija do vetëm ta dëgjojnë". Ai rekomandon metodën ACBD qe do te thotë: Gjithmonë konsultohu, (me fëmijën), përpara se të vendosësh.

Gjeni gjuhën e përbashkët

Negociatorët e suksesshëm, thotë Shapiro, kthejnë një situatë nga gjendje mosmarrëveshje në bashkëpunim për zgjidhjen e problemeve. Kujtojini fëmijës se keni të njëjtat mendime dhe bëni që ai të bashkëpunojë me ju për të zgjidhur mosmarrëveshjet. Nëse ai dëshiron të qëndrojë gjysmë ore më vonë në darkë për të parë TV, kërkojini që të përgatisë çantën për të nesërmen që më parë. Jepni kushte që janë të favorshme për të dy palët. Një fëmijë që është mësuar me këtë frymë ka më shumë gjasa të jetë i kënaqur, duke praktikuar një aftësi shumë të çmueshme jashtë shtëpisë.

Mendoni fitim-fitim

Rregulli i Artë është shumë i rëndësishëm. Duke pranuar legjitimitetin e fëmijëse suaj kur kërkeson një "rrogë" më të madhe, kjo mund të përkojë me dëshirën tuaj që dikush të merret me hedhjen e mbeturinave.

Mos harroni kush është shefi

Vetëm sepse babai është i hapur për të diskutuar, nuk do të thotë se duhet të bëhet debat për çdo gjë. Fëmijët kanë nevojë për udhëzime dhe disiplinë, si edhe për lirinë e zgjedhjes. Kjo është një nga gjërat që duhet të pranojmë edhe në jetën e përditshme. Disa gjëra nuk janë të negociueshme.

Kompanitë e mëdha kanë lidera sepse disa vendime të vështira nuk mund të merren nga komiteti. Një shtëpi në harmoni nuk është demokraci, por një diktaturë e këndshme.

Përgatiti faqen Eriona Vangjeli

TRIBUNA SINDIKALE

